



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 801/1 prot.

Shkodër, më/3 .12.2021

Of. 6834/1 Prot
Dt. 16.12.21

Lënda: Mbi vendimin nr. 64, datë 26.11.2021 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107, dt. 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, neni 56, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.3, shkronja b, neni 34, pika 3, neni 35, neni 36, neni 37, pika 1, neni 54, shkronja “f”, neni 55, pika 3, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni neni 4, neni 5, neni 6, shkronja c, neni 7, pika 1, neni 25, të ligjit nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, neni 17 dhe 18, të VKB nr. 71, datë 26.11.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021 në Bashkinë Vau Dejës”, të ndryshuar, të shkresës së KB Vau Dejës nr. 6831prot., datë 02.12.2021 “Dokumentacioni i mbledhjes së KB Vau Dejës të datës 26.11.2021”, shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 64, datë 26.11.2021 “Për disa ndryshime në VKB nr. 71, datë 26.11.2020 për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021 në Bashkinë Vau Dejës”, i ndryshuar.

Pas trajtimit, Prefekti autorizon procedim të mëtejshëm, përveç pikës II.12. “E ardhura nga tarifa të mirëmbajtjes së infrastrukturës kullim-ujitje dhe tarifës së shërbimit të ujitjes”, për të cilën ka një qëndrim zyrtar të Prefektit të datës 11.08.2021. Ju risqarohet se heqja e tarifës vjetore të mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit dhe tarifa e shërbimit të ujitjes, si detyrim ligjor referuar ligjit nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, neni 17 dhe 18, sjell mungesë shërbimi për komunitetin, në rast mosmbledhjeje të saj.

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nuk parashikojnë përjashtim apo heqje të tarifave vendore.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T

Mailinda ANGONI





**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 64 datë 26.11. 2021

**Për disa ndryshime në VKB Nr.71 datë 26.11.2020 “Për miratimin e Taksave dhe
Tarifave Vendore për vitin 2021”**

NË BASHKINË VAU-DEJËS

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”; Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje”, i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “ Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007, “ Për fondin kullësor” i ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar; VKM Nr. 319/2018, date 31.05.2018 “Per miratimin e masave per kostot e manaxhimit te mbetjeve”, Ligjin nr. 152/2015, datë 21.12.2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; VKM nr. 607, date 29.07.2020, “Per tarifate sberbimeve qe kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi ndaj shtetasve dhe personave juridik e fizik vendas e te huaj”, Ligjin nr. 68/2017, date 27.04.2017 “Per financat vendore”,ne Ligjin nr.24/2017 “Per administrimin e ujitjes dhe te kullimit”, ne VKM nr. 132,date 07.03.2018 “Per Metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise se paluajtshme “ndertesa”, e baze se takses per kategori specifike, natyren dhe prioritetin e informacionit dhe te dhenave per percaktimin e baze se takses, si dhe te kritereve dhe rregullave per vleresimin alternativ te detyrimit te takses,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

Për disa ndryshime në VKB Nr.71 datë 26.11.2020 “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2021”

NË BASHKINË VAU-DEJËS

2. Efektet fillojnë shtrihen nga 01.01.2022 deri me 31.12.2022
3. Ngarkohen Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vau-Dejës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR

Mark Bisha

Sekretari i Këshillit BashkiaK

Ardian Celepija

Miratur me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.12.2021





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

VENDOSI:

1. Për disa ndryshime në VKB Nr.71 datë 26.11.2020 “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2021”

NË BASHKINË VAU-DEJËS

3. Efektet fillojnë shtrihen nga 01.01.2022 deri me 31.12.2022.
4. Ngarkohen Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vau-Dejës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETARI

Mark BABANI

NË MUNGESË DHE ME URDHER

ZV/ KRYETAR

Lestinë NDOJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Drejtoria Ekonomike

P/Financës Albert Maloci

Drejt.Sherb.Pub.Ars.Rin.Shendetsise

P/Sherbimare Eshbol Gjeneri

Drejt.Mbrojtjes,Kujdesit,Perf.Sociale

Greta Bekani

Drejt.Buri.Njerzore,Sh.Mbeshtetese

BIB VARRIA

Sektori Menaxhimit Pyje Kullota

Zepi Uytay

Sektori Planif.Urban dhe S.Teknike

Dorina Selaj

Sektori Aseteve

Ado Bopli

IVMT

Ing Martin Leka

Drejtoria Juridike, Prok. dhe Integrim

P/Sik ligjor Kristina Shkati

Drejt.Planif.Territorit.Inv.Publike

Ana Shushko

Drejt.Zhvill.Rural,Turizmit,Mbr.Mjedisit

Rrolo Ftuni

Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore

Mark Gjeco

Sekt.Bujq.Ujit-Kull.Mbr.Konsumatorit

Joli Pacion

Sektori i Fuqizimit Ekonomik

Nazire Buremi

Sherbimi i MZSH

Policia Bashkiake

Ilir Gjokani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
(DREJTORIA EKONOMIKE)
(SEKTORI TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE)



RELACION

Per disa ndryshime ne VKB nr. 71, date 26.11.2020 „Per miratimin e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2021 ne Bashkine Vau-dejes“

I.1. TATIMI THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Ishte

Mbeshtetur ne ndryshimet e fundit ligjore te Ligjit 9632, date 30.10.2006 “Per Sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar me **ligjin Nr. 122/2020, date 15.10.2020, neni 1**, ku ka ndryshuar shkalla tatimore per subjektet qe ushtrojne një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit nje qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, u nenshtrohet detyrimeve te parashikuar ne ligj.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vleresimin, dhe kontrollin e tatimpaguesve, subjekt i tatimit te thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel.

Cdo tatimpagues, subjekt i tatimit te thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel, eshte i detyruar qe deri me date 10 shkurt te vitit qe pason periudhen tatimore te dorezoje nje deklarate vjetore tatimore , ku te jepen hollesisht te ardhurat gjithsejt , shpenzimet e zbritshme , fitimi i tatueshem , si dhe cdo hollesi tjetere e perckatuar me udhezim te ministrit te Financave dhe Ekonomise, per plotesimin dhe dorezimin e deklarates tatimore vjetore.

Niveli I tatimit: Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël paraqiten si më poshtë

Nr.	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	Njesia	Niveli i takses
I.1.1	Me xhiro vjetore 0 – 8.000.000 leke	Leke/vit	0% e fitimit

Hiqet

Ne baze te ligjit Nr. 122/2020, date 30.10.2020 „Per disa ndryshime ne ligjin Nr. 9632, date 30.10.2006 „per sistemin e taksave vendore“, ka ndryshuar shkalla tatimore e tatimpaguesve te Tatimit te thjeshtuar mbi fitimin, e cila ka kaluar ne llogari te Bashkise Vau-Dejes.

I.2. TAKSA MBI PASURINE E PALUAJTSHME

I.2.1. Taksa mbi ndertesat:

ishte:

Sipas VKM nr. 138, date 07.03.2018, aneksi 2,

A. Ndërtesa qe sherbejne per banim, dhe aktivitet privat. Nendarjet zonale			
Nendarjet Zonale dhe Kategorite	Shkalla e takses % +/-30%	Cmimi references ne m2 Aneksi 1	Vlera ne lek/m ² /vit miratuar
A.6. Per parkim te hapur (30% e cmimit te baneses Aneksi 1)	0.20%	7290	14.58
A.7. Per veprimtari industriale (50% e cmimit te baneses Aneksi 1)	0.20%	12150	24.3



I.2. TAKSA MBI PASURINE E PALUAJTSHME

I.2.1. Taksa mbi ndertesat:

behet

ndryshuar me VKM nr. 144, date 13.2.2020, aneksi 2, pikat c, dhe ç, duke bere vetem shtesa ne kategori objekt aktiviteti, ndersa tarifa nuk ka ndryshuar.

A. Ndërtesa qe sherbejne per banim, dhe aktivitet privat. Nendarjet zonale			
Nendarjet Zonale dhe Kategorite	Shkalla e takses % +/-30%	Cmimi references ne m2 Aneksi 1	Vlera ne lek/m ² /vit miratuar
A.6. Per parkim te hapur, pishine e hapur, ambjente sportive te hapur te tilla si fusha futbollit, minifutbollit basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista per gara te ndryshme sportive te atletikes, motorike, garave me kuaj, e te tjera te ngjashme me to, porte, aeroporte te cdo kategorie per te gjitha sip. e shtrire qe ato zene. (30% e cmimit te baneses Aneksi 1)	0.20%	7290	14.58
A.7. Per veprimtari industriale, te tilla si prodhim, perpunimapo magazinim te lendeve te para, te gjysmeprodukteve apo te produkteve te gatshme industriale, si fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike te produkteve ushqimore(perjashtuar ato te tregtimit e sherbimit) si dhe objekte te tjera te ngjashme me to si dhe ndertesat me vepimtari arsimore jopublike te cdo niveli, si dhe ambjentet sportive te mbyllura dhe pishinat e mbyllura (50% e cmimit te baneses Aneksi 1)	0.20%	12150	24.3

I.3. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURE NGA NDËRTIMET E REJA

Ishte:

Tabela nr. 5

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	Sipas ligjit në % te çmimit të shit-blerjes per m ²	Niveli taksës për vitin 2022
Për ndërtime te destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi e sherbimi, te cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi.	4% - 8% çmimit të shit-blerjes	4.0% çmimit të shit-blerjes
Ndërtime për njësi sherbimi , te cilat nuk destinohen per perdorim ne sektorin e turizmit, industrise, apo perdorim publik.	4% - 8% çmimit të shit-blerjes	4.0% çmimit të shit-blerjes
Ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër.	1% - 3% e vleres investimit	1.0% vleres investimit
Per projektet e infrastrukturë shtetërore, per ndertimin e rrugeve kombetare,porte aeroporte, tunele,digave., ndertimit te infrastrukturës ne energji, perfshire makinerite dhe paisjet per keto projekte, kjo takse eshte 01% vl.investimit, <i>por jo me pak se kostoja e rehabilitimit te infrastrukturës se demtuar</i> , kur kjo kosto nuk eshte perfshire ne preventivin e investimit.	0.1% vleres investimit	0.1% vleres investimit
Te gjitha ndërtimet e reja të cilat janë në proces legalizimi	0.5% vleres investimit	0.5% vleres investimit
Ndertesat qe destinohen per qellime banimi ne zonat malore, ku perfshihen (N.J.A. Temal, Shllak, Vig-Mnele)qe miratohen nga KB.	0-3% vleres investimit	3% vleres investimit

Behet

Tabela nr. 5

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	Sipas ligjit në % te çmimit të shit-blerjes per m ²	Niveli taksës për vitin 2022
Për ndërtime te destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi e sherbimi, te cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi.	4% - 8% çmimit të shit-blerjes	4.0% çmimit të shit-blerjes
Ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër. <i>(Ndertime qe destinohen per perdorim ne sektorin e turizmit industrise , bujqesise te ndertimeve individuale, per qellime te perdorimit vetjak nga individet, te ndertuara nga vete individet apo me sipermarres, si dhe te ndertimeve per qellime publike)</i>	1% - 3% e vleres investimit	1.0% vleres investimit
Per projektet e infrastrukturë shtetërore, per ndertimin e rrugeve kombetare,porte aeroporte, tunele,digave., ndertimit te infrastrukturës ne energji, perfshire makinerite dhe paisjet per keto projekte, kjo takse eshte 01% vl.investimit, <i>por jo me pak se kostoja e rehabilitimit te infrastrukturës se demtuar</i> , kur kjo kosto nuk eshte perfshire ne preventivin e investimit.	0.1% vleres investimit	0.1% vleres investimit
Te gjitha ndërtimet e reja të cilat janë në proces legalizimi	0.5% vleres investimit	0.5% vleres investimit

Ndertesat qe destinohen per qellime banimi ne zonat malore, ku perfshihen (NJ.A. Temal, Shllak, Vig-Mnele)qe miratohen nga KB.	0-3% vleres investimit	3% vleres investimit
--	------------------------	----------------------

“Vlere investimi” te merret vlera e percaktuar sipas cmimit te shitblerjes se EKB dhe VKM Nr. 132, date 07.03.2008, i ndryshuar, anekset 1 dhe 2, sipas kategorise se ndertesave “banim”, apo “tregti e sherbime”.

Eshte hequr kategoria e dYTE, pasi perfshihet ne kategorine e pare, dhe kane te njejten nivel takse, sic e percakton ligji.

II.6. TARIFA TË DREJTORISE SE PLANIFIKIMIT TERRITORIT DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Ishte

Nr	Emërtimi Tarifës	Niveli Tarifës për vitin 2022
II.6.1	Nderhyrje qe nuk kane nevoje per paisje me leje ndertimi (riparime)	2,000 lekë/nderhyrje
II.6.2	Aplikimi per leje zhvillimi	1,000 leke/aplikim
II.6.3	Aplikimi per leje ndertimi per banim	3,000 leke/aplikim
II.6.4	Aplikimi per leje ndertimi per objektet tjera pervec banimit	5,000 leke/aplikim
II.6.5	Aplikim per certificate perdorimi	2.000 leke/aplikim
II.6.6	Leshim fragment harte e azhornuar	1.000 leke/harte
II.6.7	Aplikim per leje per ndryshim funksioni	2.000 leke/aplikim
II.6.8	Aplikim per leje per prishje objekti ekzistues	1,000 leke/aplikim
II.6.9	Aplikim leje per ndryshim projekti gjate ndertimit	5,000 leke/leje
II.6.10	Aplikimi per leje infrastrukture	15,000 leke/leje/vit

Behet:

Nr	Emërtimi Tarifës	Niveli Tarifës për vitin 2022
II.6.1	Aplikimi per leje zhvillimi	1,000 leke/aplikim
II.6.2	Aplikimi per leje ndertimi per banim	3,000 leke/aplikim
II.6.3	Aplikimi per leje ndertimi per objektet tjera pervec banimit	5,000 leke/aplikim
II.6.4	Aplikim per certificate perdorimi	2,000 leke/aplikim
II.6.5	Aplikim per leje per ndryshim funksioni	2.000 leke/aplikim
II.6.6	Aplikim per leje per prishje objekti ekzistues	1,000 leke/aplikim

II.6.7	Aplikim leje per ndryshim projekti gjate ndertimit	5,000 leke/leje
II.6.8	Aplikimi per leje infrastrukurore	15,000 leke/leje/vit
II.6.9	Aplikim i ndryshimit te subjektit zhvillues	15,000 leke/aplikim
II.6.10	Aplikim i ndryshimit te subjektit zbatues	15,000 leke/aplikim
II.6.11	Aplikim per njoftim te raportit te mbikqyrjes	1,500 leke/njoftim
II.6.12	Aplikim per njoftim te raportit te kolaudimit	1,500 leke/njoftim
II.6.13	Aplikim per njoftim per fillim punimesh	1,000 leke/njoftim

Ketu hiqen dy tarifa, kategoria e pare II.6.1, hiqet, pasi ne baze te VKM 408, neni 6, nuk ofrohet ky sherbim ndaj banorit, pasi nuk perfshihet as ne sistemin e e-lejeve, dhe si rrjedhoje nuk mund te tarifohet, po ashtu edhe katetoria II.6.6, edhe ky sherbim nuk ofrohet nga Bashkia, por nga institucione te tjera si ASHK.

Shtohen 5 sherbime te tjera te kerkuara nga banoret gjate vitit 2021, te cilat rrjedhin nga efektet e lejeve te ndertimit, sipas relacionit te drejtorise perkatese.



II.7. TARIFA TË SHËRBIMIT VETERINAR

Ishte:

Baza ligjore:

Ligji nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Udhezimi i përbashket nr. 08 datë 08.05.2007” midis Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Bujqësisë mbi tarifën e te ardhurave dytore te aplikueshem nga institucionet vartese te Ministrise se Bujqesise Ushqimit dhe Mbrojtjes Konsumatore.

Tabele nr. 17

Nr	Tarifa për vulosje veterinare të bagetive të therura në pikat e autorizuar	Njësia	Tarifa
II.8.1	Për bagëti të trasha	Lek/kokë të therur	100
II.8.2	Për bagëti të imëta + derra	Lek/ kokë të therur	50
II.8.3	Për 100 shpend	Lek/ 100 kokë të therur	100
II.8.4.	Çertifikatë Shëndetësore veterinarë për bagëti të trasha, për levizje, treg dhe therje	Lek/koke	100
II.8.5.	Çertifikatë veterinare për shpend konsumi/1.000 krerë, për levizje, treg dhe therje	Lek/kokë	200
II.8.6.	Çertifikatë Shëndetësore veterinare për bagëti të imta + derra, për levizje, treg dhe therje	Lek/kokë	50
II.8.7.	Çertifikatë veterinare për shpend konsumi mbi 1.000 krerë, për levizje, treg dhe therje	Lek/kokë	1.000

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës :

Veterinerët përcjellin informacionin tek sektori i të taksave dhe tarifave vendore.

Tarifat mbulohen nga subjekti që përfiton shërbimin.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimeve është sektori i taksave dhe tarifave vendore, në bashkëpunim me sektorin e veterinarisë.

Hiqet:

Pasi mbeshtetur në ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Per shërbimin veteriner në Republikën e Shqipërisë”, neni 54, pika ç, ka qene e percaktuar kryerja e shërbimit nga ana e Bashkisë, dhe në baze të urdherit Nr. 366, datë 08.09.2021 të Ministrisë Bujqesive dhe Zhvillimit Rural, kjo kompetencë i ka kaluar Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimeve, dhe si rrjedhojë edhe tarifat kalojnë tek institucioni që kryen shërbimin.



II.11. TARIFAT E PAGESAVE PËR LIÇENSA/AUTORIZIME/ÇERTIFIKATA QË LËSHOHEN NË FUSHËN E TRANSPORTIT RRUGOR.

Ishte

A.	Tarifa te liçensimit të transportit të udhëtarëve	Njësia	Tarifa
II.10.3.A.a.1	Çertifikate për kryjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të udhëtarëve	Lek/mjet/vit	7,500

Behet

A.	Tarifa te liçensimit të transportit të udhëtarëve	Njësia	Tarifa
II.10.3.A.a.1	Çertifikate për kryjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të udhëtarëve	Lek/mjet/vit	1,500

Tarifa është shënuar gabim tarifa në vlerë, pasi është vendosur duke u supozuar për 5 vite, në një kohë që certifikata të tilla leshohen 1-vjeçare, sic është e percaktuar tek kolona “Njësia”.

II. 12. E ARDHURA NGA TARIFA TE MIREMBAJTJES SE INFRASTRUKTURES KULLIM-UJITJE DHE TARIFES SE SHERBIMIT TE UJITJES

Ishte:

Përmbledhësja e tarifës së mirëmbajtjes së infrastruktures të Kullimin, si Bashki është si mëposhtë:

Nr	Njesia Administrative	Siperfaqja e tokes/Ha	Çmimi/ha
1	Qender Vau Dejës	1024.08	400
2	Bushat	5783	550
3	Hajmel	2281	500
4	Vig	530	300
5	Temal	111	200

6	Shllak	114	200
	Shuma totale	9843.08	

Tarifa e Ujitjes për çdo Njësi sipas Njësive Administrative

Nr	Njesia Administrative	Siperfaqja e tokes/Ha	Çmimi /Ha
1	Qender Vau Dejës	910	2000
2	Bushat	5783	3000
3	Hajmel	1849	2500
	Shuma totale	8542	

Hiqet

Me propozim dhe me relacionin bashkelidhur te Sektorit i Bujqesise.



IV. 5

Te tjera:

Ishte:

Për subjektet që regjistrohen për here të parë , niveli i taksave dhe tarifave vendore do të llogaritet proporcionalisht me pjesen e mbetur të vitit.

Përgjegjësia tatimore e tatimpaguesit për llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore nderpritet kur:

- Në datën e aplikimit pranë QKB-it për pezullim të aktivitetit, çrregjistrim, kalim në regjistrin pasiv, likuidim ose faliment të biznesit të vete.
- Në datën e aplikimit pranë QKB-it për mbylljen e çdo adresë dytsore pranë QKB-së dhe nuk ushtron aktivitet në këtë vendodhje.

behet

Te tjera:

- Sektor i Taksave dhe tarifave vendore.
 - Per taksapaguesit biznese dhe institucione, duhet qe brenda 3-mujorit te pare te vitit 2022, te pergatise dhe te njoftoje keto subjekte per detyrimet vjetore qe kane ndaj Bashkise Vau-dejes, ndersa afati per pagesen e tyre te jete data 30.06.2022.
 - b. Per taksapaguesit familjar, afati i pergatitjes se njoftim detyrimit vjetor dhe njoftimi te behet brenda dates 30 qershor vitit 2022 dhe afati i pageses te jete data 31.12.2022.

c. Per detyrimet e tjera qe nuk jane vjetore, por sipas kerkeses se taksapaguesit qe ben gjate vitit per marrjen e nje sherbimi te tarifueshem, njoftimi per detyrime te behet ne momentin e marrjes se ketij sherbimi, duke plotesuar dokumentacionin perkates.

➤ Baza e te dhenave per taksat dhe tarifate vendore, eshte si me poshte:

Të dhënat bazë	Burimi i zyrtar për Bazën e tarifës	Burimi zyrtar për lehtësira fiskale
Numri i familjeve	Database e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile	Zyra e Ndihmës Ekonomike
Numri i bizneseve	Qendren e Regjistrimit të Biznesit	Zyra e taksave vendore
Adresa e vendndodhjes për çdo biznes	Qendren e Regjistrimit të Biznesit	Zyra e taksave dhe tatimeve
Kategoritë e biznesit dhe lloji i aktivitetit	Qendren e Regjistrimit të Biznesit	Zyra e taksave dhe tatimeve

- Pagesat kryhen nepermjet bankave te nivelit te dyte, ose dhe nepermjet postes shqiptare.
- Për subjektet që regjistrohen për here të parë , niveli i taksave dhe tarifave vendore do të llogaritet proporcionalisht me pjesen e mbetur të vitit.
- Per subjektet biznese, qe formen ligjore ne QKB e kane SHPK, por prane Drejtorive Rajonale Tatimeve jane rregjistruar me pergjegjesi tatimore me Tatim-fitimit thjeshtuar, duhet te trajtohen si biznes i vogel me TFTII, deri ne momentin e ndryshimit te xhiros, duke paraqitur dokumentin perkates nga sistemi i Tatimeve.
- Përgjegjesia tatimore e tatimpaguesit për llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore nderpritet kur:
 - c. Në datën e aplikimit pranë QKB-it për pezullim të aktivitetit, çrregjistrim, kalim në regjistrin pasiv, likuidim ose faliment të biznesit të vete.
 - d. Në datën e aplikimit pranë QKB-it për mbylljen e çdo adresë dytsore pranë QKB-së dhe nuk ushtron aktivitet në këtë vendodhje.

Pikat e tjera te VKB se mesiperme, nuk kane pesuar ndryshime.